

Ndërmarrja Publike Lokale **KASTRIOTI** Sh.A

Adresa: Rr. "Vashingtoni" pn - Obiliq
Tel: +383 46666607; +383 48777624

Email: nplkastrioti@gmail.com; web: www.nplkastrioti.com



Bazuar në Planin e Biznesit me nr prot 1143/23 si dhe Udhëzimit Administrativ për rregullimin e procedurave të konkursit në sektorin publik NR..01/2024 të nenit 4.1.5.1 dhe 5.2, në Statutin e Ndërmarrjes me nr prot 1259/23 të nenit 36 paragrafi 36.3, procesverbalin e Bordit të Drejtorëve me nr prot 1423/23 dhe vendimit me nr protokolli 1282/24 datës 30/08/2024 Ndërmarrja Publike Lokale "Kastrioti" Sh.A Obiliq me datën 02/09/2024 shpallë:

KONKURS

Për plotësimin e vendeve të punës

Pozita: Punëtor për fotografi, video dhe montazhë

Numri i punëtorëve: 1

Orari i punës: i plotë

Kohëzgjatja e kontratës: 6 muaj punë provuese

Vendi: Obiliq

Detyrat dhe përgjegjësitë e përgjithshme

- Është përgjegjës për realizimin e objektivave të caktuara nga mbikëqyrësi, i cili është në kuadër të ndërmarrjes;
- Ndihmon Menaxherin dhe bashkëpunon me zyrtarët e tjerë në caktimin e objektivave dhe zhvillimin e planit të punës, për përmbushjen e objektivave të Zyrës për Marrëdhënie me Publikun dhe NPL Kastrioti Sh.A në përgjithësi
- Të jetë në gjendje të siguroj fotografi profesionale, të bëjë montazh, video dhe të siguroj material të mjaftueshëm dhe të nevojshëm për zhvillimin e PR-it dhe Marketingut të ndërmarrjes;


Detyrat dhe përgjegjësitë specifike

- Organizon procesin e marrjes së fotografive dhe videove që nga fillimi deri në përfundim të ngjarjeve, punëve, eventeve etj., të caktuara nga ndërmarrja;
- Të përcjellë me fotografi dhe video gjendjen e ndërtesave para dhe pas renovimeve dhe investimeve, të cilat janë pjesë e projektit për Renovim dhe Mirëmbajtje të objekteve të ndryshme nga ndërmarrja;
- Merrë pjesë në takimet e menaxhmentit të ndërmarrjes si dhe organizon, propozon dhe ndihmon në shtrirje të strategjisë së marketingut dhe PR-it në rrjete sociale;
- Është përgjegjës për sigurimin e fotografimeve dhe videove profesionale që ndihmojnë në zhvillimin e PR-it dhe Marketingut të NPB-së;
- Është përgjegjës për ruajtjen e pajisjeve të punës;
- Mban evidencë për të gjitha punët të cilat realizohen si dhe raporton tek mbikëqyrësi;

Aftësitë:

- Të ketë aftësi kompjuterike të programeve Microsoft Office si dhe në programet për editim të fotove dhe videove, në veçanti në programet ADOBE COLLECTION;
- Të njoh pajisjet/aparatet për fotografi dhe video duke përfshirë dhe dronët;
- Aftësi të mirë në përdorimin e bazave të të dhënave;
- Në gjendje për të punuar nën presion dhe me orar të zgjatur;
- Njohuritë e qasjeve moderne në planifikim dhe kontrollë;
- Shkathtësi të shkëlqyera komunikative, organizative dhe analitike;
- Etikë në punë dhe integritet të lartë;





Ndërmarrja Publike Lokale **KASTRIOTI** Sh.A

Adresa: Rr. "Vashingtoni" pn - Obiliq

Tel: +383 46666607; +383 48777624

Email: nplkastrioti@gmail.com; web: www.nplkastrioti.com

- Shkathtësi për të punuar në grup dhe të dëshmojë fleksibilitet në punë;

Kualifikimet:

- Të këtë të përfunduar shkollën e mesme;
- Bartësi i vendit të punës duhet të ketë së paku 2 vjet përvojë pune në pozitën e kërkuar;
- Të ketë njohuri të gjuhës angleze;
- Përparësi kanë kandidatët që kanë të kryer kurse apo trajnime për fotografi, kamerë, montazhë dhe dizajn grafik;
- Të ketë njohuri rreth punës dhe mirëmbajtjes së rrjeteve sociale
- Patentë shofer kategoria-B;

Procedura e Konkurrimit:Kandidati-ja për pozitën *Fotograf – Kameraman në NPL Kastrioti Sh.A* duhet t'i dorëzoi këto dëshmi:

- **Aplikacionin**
- **CV-në,**
- **Dëshminë e kualifikimit,**
- **Dëshminë mbi përvojën e punës**
- **Kopjen e letërnjoftimit,**
- **Çertifikatën e cila dëshmon që nuk është i/e dënuar (jo më e vjetër se 6 muaj),**
- **Kopjen e Patentë Shoferit dhe**
- **Referenca të tjera që janë të rëndësishme**

Dokumentet e kompletuara duhet të dorëzohen përmes e-mailit zyrtar:

konkursetnplkastrioti@gmail.com

Kandidatët të cilët konkurrojnë duhet ta shënojnë saktë vendbanimin, numrin e telefonit kontaktues dhe e-mail adresën.

Vetëm kandidatët e përzgjedhur do të ftohen për testin me shkrim. Dokumentet e pa kompletuara si dhe ato që arrijnë pas skadimit të afatit të konkursit nuk do të shqyrtohen.

Konkursi është i hapur nga data 02/09/2024 deri me 16/09/2024

